



REPUBLIC OF KOSOVO	
DPK 2 fje 01/2308/13 31.07.13	01/2308/13 31.07.13



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **23.07.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-478/13 për z. Ismail Rudari – Drejtor i Administratës në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH), për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-478-13, për Zyrtarin e lartë, z. Ismail Rudari – Drejtor i Administratës në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-478/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Rudari së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-1297/2013), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Rudari është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pasi kanë kaluar afatet administrative për ndryshime të kësaj gjendje dhe ztr. Rudari nuk i ka bërë ndryshimet e nevojshme, Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë edhe shkresën e dytë që quhet Paralajmëruese (Z.D./DPK-01-2100/13), me njoftimin për masat që mund të pasojnë nëse në afat të caktuar nuk bëhen ndryshimet e gjendjes për të parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Z.Rudari me datë 16.07.2013 në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-2116/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte te Kompania e huaj me degë në Kosovë; “Erel Elektroteknik Muhendislik Makina Taahhut Ticaret Sanayi Ve Yatirim AS”, duke autorizuar një person të besuar, për të ushtruar vet funksionin e tij si zyrtar i lartë publik në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH).

Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

